



REPUBLIKA E KOSOVËS QEVERIA E KOSOVËS VLADA E KRYEMINISTRIT	REPUBLIKA KOSOVA VLADA KOSOVA UREQ PRIMJERA	REPUBLIC OF KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA OFFICE OF THE PRIME MINISTER	
SEKTORI I ARKIVES	SEKTOR ARHIVE	ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinice Org. Unit	2.1.9	Nr. Prot. Broj Prot. Prot No:	625
Nr.faqeve Br. stranic No. pages	-4-	Data: Datum: Date:	09 / 05 / 2020
Prishtinë/а			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komisioni Disiplinor - Disciplinska Komisija - Disciplinary Commission

KD-Nr.01/2020
5 maj 2020

Komisioni Disiplinor për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues, i themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/25 të datës 17 prill 2020, në mbështetje të nenit 71, 72, 73, 74, 75, 77 dhe 78 të Ligjit nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15, 17, 18, 19 dhe 20 të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, më 5 maj 2020 merrë këtë:

V E N D I M

1. **Z. Rrahim RAMA**, i emëruar në pozitën **Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar**, i shqiptohet masa disiplinore - **Ndërprerje e marrëdhënies së punës**.
2. **Z. Rrahim Rama**, i ndërprehet marrëdhënia e punës në pozitën e lartëshënuar, pasi që njejt gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë të punës së tij në pozitën **Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar**, ka bërë shkelje të rënda dhe të shumta të detyrave të punës, përkatësisht të nenit 2 paragrafin 1 nën paragrafi 1.6, nenit 3, nenit 4 pika 1.3 dhe 1.5, nenit 8, pika 4, nenit 12, nenit 17 pika 3, neni 19 pika 4 dhe 5, nenit 19 pika 5, nenit 29, nenit 31 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Ligjit Nr. -03/L-149, të nenit 36 pika 1, nenit 51, nenit 52, nenit 55, nenit 57, nenit 58, nenit 59, nenit 60 dhe nenit 61 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shkelje të nenit 487 pika 3 të Kodit Nr. 04/L-123 për Procedurën Penale, si dhe nenit 3 dhe nenit 10 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2017 për Mënyrën dhe Procedurën e Shitjes së Pasurive të Luajtshme të Sekuestruara.
3. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues, ka shqyrtuar me kujdes lëndën Nr. 01-01/2020 me të cilën Znj. Albulena Haxhiu, Ministre e Ministrisë së Drejtësisë, e ka njoftuar dhe njëherit ka kërkuar nga Kryeministri dhe Sekretariati Koordinues i Qeverisë, për iniciimin e

procedurës disiplinore ndaj Z. Rrahim RAMA, Kryeshf Ekzekutiv i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.02/25, të datës 17 prill 2020, e ka themeluar Komisionin Disiplinor sipas legjislacionit në fuqi, në përbërje të z. Haki Abazi, Zëvendëskryeministër, kryesues, z. Xhelal Sveçla, U. D. Ministër i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, anëtar, znj. Emilija Redzeqi, Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtare, z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, anëtar dhe znj. Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore, anëtare.

Komisioni Disiplinor në mbledhjen e mbajtur më datën 30 prill 2020, e shqyrtoi lëndën dhe hapat të mëtutjeshëm që duhet të ndërmerren lidhur me shqyrtimin e kësaj lënde dhe këtij rasti duke i respektuar të gjitha procedurat e parapara me legjislacionin e aplikueshëm, në pajtim me nenin 71, 72, 74 dhe 77 të Ligjit Nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 19 të Rregullores Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Komisioni Disiplinor vendosi që në takimin e radhës, të përcaktuar me datë 4 maj 2020, të ftohet në seancë dëgjimore ministri znj. Albulena Haxhiu, si parashtrues e kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, si dhe të ftohet në seancë dëgjimore z. Rrahim Rama, ndaj të cilës është kërkuar inicimi i kësaj procedure.

Komisioni Disiplinor në përbërje të plotë me datën 4 maj 2020, në seancën dëgjimore e priti dhe e dëgjoji Ministren znj. Albulena Haxhiu, lidhur me kërkesën e parashtruar dhe shpjegimin e shkeljeve të pretenduara nga ana e z. Rrahim Rama.

Ndërsa, z. Rrahim Rama, nuk morri pjesë në seancën dëgjimore për të cilën ishte i ftuar të ishte prezent më datë 4 maj 2020, për çka i njëjti, i cili ishte ftuar me kohë (më datë 30 prill) për të marr pjesë në seancë dëgjimore. Lidhur me këtë, Z. Rrahim Rama nuk ka marrë pjesë në seancën dëgjimore, me arsyetimin se ka simptome të gripit aktual Covid-19, duke e dërguar me e-mail njoftimin në adresë të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë një Raport nga Qendra Spitalore në Prishtinë për gjendjen e tij. Për këtë raport mjekësor, komisioni konsideroi se nuk është zyrtarë raporti mjekësor i dërguar dhe të njëjtit i mungon vula dhe protokolli zyrtar i institucionit përkatës, e po ashtu z.Rama nuk ka dërguar raport nga Qendra e Mjekësisë së Punës, përmes së cilit dëshmohet se i njëjti ka hapur pushimin mjekësor zyrtarisht.

Duke e pasur parasysh situatën e Pandemisë me Covid-19 dhe në pamundësi për të marr pjesë fizikisht, komisioni vendosi që z. Rrahim Rama për datën 5 maj 2020, që t'i mundësohet mbajtja e seancës dëgjimore përmes komunikimit elektronik virtual/video linkut ose telefonit, për të realizuar prezantimin e dëshmive të tij dhe sqarimeve të tij.

Me datën 5 maj 2020, Komisioni Disiplinor në përbërje të plotë ishte në pritje të paraqitjes së dëshmive të z. Rrahim Rama përmes pjesëmarrjes fizike, apo komunikimit elektronik virtual/video linkut ose telefonit, por i njëjti, nuk është paraqitur fare.

Komisioni Disiplinor pas administrimit të shkresave të lëndës dhe pas dëgjimit të parashtrueses së kërkesës, përkatësisht të Ministres së Drejtësisë, konstatoi se:

- I. Ka vepruar në kundërshtim dhe ka bërë shkelje të nenit 17 pika 3, dhe neni 19, pika 3 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, pasi që Z. Rama, me neglizhencë e ka dëmtuar buxhetin e shtetit, duke e mbajtur gjendjen e depos pa infrastrukturë, pa mbulim dhe pa asfaltim, ku bëhet vendosja e materialeve dhe aseteve të sekuestruara apo të konfiskuara duke e dëmtuar vlerën e tyre dhe duke rrezikuar buxhetin e shtetit, që në rast të kthimit të këtyre aseteve, pronari kërkon në raste të caktuar që të bëhet kompensimi i dëmtimit të aseteve.
- II. Ka vepruar në kundërshtim dhe ka bërë shkelje të nenit 4 pika 1.5 dhe neni 12 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, dhe neni 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2017 për Mënyrën dhe Procedurën e Shitjes së Pasurive të Luajtshme të Sekuestruara. Kjo, pasi që z. Rama me neglizhencë e ka pamundësuar funksionalitetin e data bazës duke mos siguruar kodin për qasje në data bazë, e cila është e punuar dhe paguar dhe do të ishte në dispozicion aktiv të Agjencisë, i cili e ka bërë të vështirë kryerjen në mënyrë profesionale punën e data bazës në fjalë.
- III. Ka vepruar në kundërshtim dhe ka bërë shkelje të nenit 3, dhe neni 19 pika 5 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe neni 10 pika 2,3 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2017, për Mënyrën dhe Procedurën e Shitjes së Pasurive të Luajtshme të Sekuestruara. Ashtu që, leijimi nga z. Rama i shitjes së veturave pa një raport të vlerësimit, nga rishikimi i raporteve të vlerësimit teknik dhe financiar të veturave, që janë bërë nga Komisionit vlerësues, në shumicën dërmuese Komisioni Vlerësues nuk ka marrë parasysh kilometrazhin e automjeteve motorike dhe të njëjtat nuk prezantohen në raportet e vlerësimit, edhe pse ky ka qenë faktori vendimtar në përcaktimin e çmimit të përafërt të veturës sipas tregut vendor.
- IV. Ka vepruar në kundërshtim dhe ka bërë shkelje të nenit 2 paragrafin 1 nen paragrafi 1.6 lidhur me nenin 3 dhe nenin 29 si dhe neni 31 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe neni 10 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2017, për Mënyrën dhe Procedurën e Shitjes së Pasurive të Luajtshme të Sekuestruara. Me këtë rast, z. Rama ka bërë neglizhencë të plotë në menaxhimin e pasurisë të paluajtshme, duke mos iniciuar propozimin, draftimin dhe miratimin e Rregullores për shitjen e tyre për nëntë (9) vite sa ka qenë në krye të funksionit të tij.
- V. Ka vepruar në kundërshtim dhe ka bërë shkelje të nenit 4 pika 1.3, neni 19 pika 4 të Ligjit Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe neni 487 pika 3 të Kodit Nr. 04/L-123 për Procedurën Penale. Me ç'rast z. Rama, në mënyrë jo ligjore ka dhënë në shfrytëzim makinat dhe asetet e konfiskuara pa autorizim, përfshirë edhe një makinë nga vetë ai, që është e palejueshme që të bëhet një gjë e tillë.
- VI. Ka vepruar në kundërshtim dhe ka bërë shkelje të nenit 8 pika 4 të Ligjit Nr. 05/L-049, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Z. Rama ka refuzuar të raportoi tek Ministria për punë dhe obligimet që duhet ti kryejë, duke formuluar përgjigjen e tij se ai është i obliguar vetëm një herë në vit t'i raportoi Ministres.
- VII. Ka vepruar në kundërshtim dhe ka bërë shkelje të nenit 36 pika 1 të Ligjit Nr. -03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në bazë të dëshmimeve të Ministres së Drejtësisë znj. Haxhiu dhe stafit mbështetës të saj, atë që ka prezantuar në seancën dëgjimore të datës 04 maj 2020, është konstatuar se z. Rama nuk i është përgjigjur

kërkesave të Ministren e Drejtësisë, si dhe sipas pohimeve të Ministries, i njehti nuk ka marrë pjesë në takime pune mes drejtorëve të agjencive të mbikëqyrura nga kjo Ministri, me çka i'a ka pamundësuar Ministres mbikëqyrjen e këtij institucioni dhe informimin e rregullt të punëve.

Të gjitha të gjeturat dhe vlerësimet për marrjen e këtij vendimi janë bërë në bazë të dokumenteve të bashkangjitura në kërkesën e parashtruar nga Ministria e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu, e cila i ka dërguar për shqyrtim në Komisionin Disiplinor.

Komisioni Disiplinor pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Ministria e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu, si dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të lëndës, si dhe seancës dëgjimore të mbajtur, komisioni me pjesëmarrje të plotë, ka votuar i tërë ashtu që, me katër (4) vota për, dhe një (1) abstenim, Komisioni Disiplinor vendosi me shumicë votash si në dispozitiv të këtij vendimi.

Anëtarët e Komisionit Disiplinor:

Haki Abazi, kryesues

Xhelal Sveçla, anëtar

Emilja Redzeqi, anëtare

Naim Bardiqi, anëtar

Edi Gusia, anëtare

Iu dërgohet:

- Z. Rrahim Rama;
- Kryeministrit në detyrë të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Ministres në detyrë të Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Arkivit të Qeverisë;
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor;

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.